



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01 Nr. 06/01-3049/26  
Kaçanik, 09.02.2026

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja **II** (dytë) e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 09 Shkurt 2026 (E Hënë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në Sallën e Komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Islam Gashi-LVV, Betim Shala-LDK, Lejla Luta-VZHK, Hafize Sallahi-AAK dhe Shemsedin Abazi-OJQ.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete Betim Shala.

Procesmbajtëse: Arianita Bajrami, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

**z.Betim Shala:** Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e **II-të (dytë)** të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2026, data 09 Shkurt 2026, me këtë :

## REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete,
2. Diskutim për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit askush, andaj rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua nga të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete,

## APROVOJ

### Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete,

**Kryesuesi i Komitetit z. Betim Shala:**

Vijomë me pikën e parë të rëndit të ditës e cila është; Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete. A është gjithëcka në rregull me procesverbalin, nëse po, po e hedh në votim.

Pra me shumicë votash, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, konstatoj se kjo pikë kalon!

## 2. Diskutim për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026;

**z. Betim Shala:** Vazhdojmë me pikën e dytë e cila është; Diskutim për hartimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026. A dëshiron dikush të marrë fjalën?

**znj. Hafize Sallahu:** Unë mendoj që në pikën e parë duhet të vendosim; Gjendjen e bizneseve, me aktivitet prioritet -Vizitë bizneseve që udhëhiqen nga gratë.

**z. Betim Shala:** A e aprovoni këtë pikë?

Atëherë me shumicë votash e vendosim në Planin e Punës për vitin 2026. Po për mbledhjet tjera cfarë pika mendoni të fusim?

**z. Shemsedin Abazi:** Ndërsa në pikën e dytë mendoj ta vendosim; Gjendja e sportit në Kaçanik me aktivitete si -Vizitë selive të klubeve; -Takim me përfaqësues të klubeve sportive, gjithmonë nëse jeni të pajtimit edhe ju!

**znj. Hafize Sallahu:** -Ndërsa tek pika tjetër mendoj të vendosim si çështje; Rastet Sociale në Kaçanik dhe gjendja e shoqatës Hendikos me aktivitete si; Takim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; Takim tek shoqata Hendikos etj.

**z. Islam Gashi:** Më pas unë mendoj që duhet të diskutojmë si çështje; Hapsirat për parqe të reja; -Mirëmbajtja e hapësirave publike; -Mungesa e parkingjeve me aktivitet; Takim me personat përgjegjës nga DSHPE.

**z. Betim Shala:** Në rregull pasi të gjithë jemi të pajtimit, këto pika po i vendosim në Plan të Punës.

Unë dua të propozoj pikën tjetër e cila mendoj që duhet të jetë pjesë e Planit; - Gjendja e shoqatave të dala nga lufta me aktivitete; -Takim me Organizatën e Veteranëve të Luftës; -Takim me Shoqatën e Invalidëve të Luftës; -Takim me Organizatën e Familjeve të Dëshmorëve

**znj. Lejla Luta:** Pas kësaj pike unë mendoj që duhet të vendosim edhe Gjendjen e Arsimit në Komunën tonë, me aktivitete si; Vizitë shkollave fillore, të mesme të ulëta dhe të larta; Takim me këshillin e prindërve etj.

**z. Shemsedin Abazi:** Poashtu pasi që tani më ra në mend mendoj që është mirë të vendosim si pikë edhe gjendjen e bujqëve dhe fermerëve në Komunën tonë, poashtu edhe të diskutojmë mbi shpërndarjen e granteve, mund të zhvillojmë aktivitete si; -Takim me drejtoreshën e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural -Vizitë bujqëve dhe fermerëve etj.

**znj. Lejla Luta:** Së fundmi unë mendoj që duhet të përfshijmë edhe rininë!

**z. Islam Gashi:** Njejtë mendoj edhe unë kolege, të vendosim një pikë si; Aktivitet Rinore, sepse komunw ssonw i duhet rini e angazhuar dhe me vullnet.

**znj. Lejla Luta:** Po, me aktivitetet si: -Takim me OJQ që merren me aktivitete Rinore; - Vizitë tek KVRL; -Vizitë tek Kryqi i Kuq, qw ti njohim mw afwr punwn dhe problemet qw ata mund tw hasin nw zhvillimin e saj, etj.

**z.Betim Shala:** A jeni të pajtimit për të gjitha këto pika?  
Atëherë konstatoj të përfunduar Planin e Punës se Komitetit për Komunitete, të vitit 2026, me përmbajtje prej 8 takimesh tejet të qëlluara dhe përplot aktivitete të cilat do ti përfundojmë me sukses!  
Na priftë e mbara!

### 3.Të ndryshme;

**z.Betim Shala:** A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme? Nëse jo, atëherë po e shpall mbledhjen të përfunduar, në ora 11:55.

Procesmbajtës:  
Arianita Bajrami



Kryesues i Komitetit:  
Betim Shala